



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS**

Elbasan, më ____ . ____ .2021

NJOFTIM

Në bazë të Urdhërit të Përbashkët Nr 6. datë 25.06.2021 të MASR nga QSHA RASH “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCESIN E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022” dhe sipas udhëzimit Nr.17 datë 30.07.2019 për “DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.05.2019 PËR “PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË,” ju njoftojmë se:

1. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë:
 - a. Master i Shkencave në ”**Matematikë e Zbatuar**”
 - b. Master i Shkencave në ”**Mbrojtje Mjedisi**”
 - c. Master Profesional në ”**Teknologjitë e Informacionit**”
 - d. Master Profesional në ”**Analist Prodhimi**”
 - e. Master Profesional në ”**Analizë të Dhënash**”

zhvillohet deri në datën **18.10.2021** prej orës **08:00** deri në orën **16:00** pranë sekretarisë me dokumentacionin përkatës.

2. Lista e aplikantëve fitues shpallet më datë **29.10.2021** brenda orës **16:00**.
3. Regjistrimi i aplikantëve të shpallur fitues zhvillohet deri në datën **13.11.2021** prej orës **08:00** deri në orën **16:00** pranë sekretarisë.
4. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtem:
 - a) Diplomë, ose fotokopje të saj të njëzuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduara në Republikën e Shqipërisë. Kandidatet që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kana shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

konform përcaktimeve të pikës 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njesuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njesimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

- b) Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njesuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njesuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse Arsimore vendore DAR/ZA). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar në Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave. Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
- c) Formulari i aplikimit (sipas shtojcës së udhëzimit)
- d) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
- e) Dy fotografi personale.
- f) Mandat pagese të tarifës së regjistrimit

DEKANI

Prof.Dr. Sotir MALI